



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 5.2.2015,
 e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Vjollca Dibra – Ibrahimimi (LDK), Naime Osmani (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Qëndron Kastrati (LVV), Ylli Hoxha, shef i GP-së (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Shaip Shabani (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Remzi Pacolli (AKR), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinofci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Besa Rafuna (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Para se të kalonin në diskutim të pikave të rendit të ditës, **kryesuesi** hapi debatin rreth rendit të ditës.

Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, i informoi të pranishmit, duke shtuar se anëtarët e subjektit politik nga radhët e PDK-së, të emëruar si anëtarë të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, japin dorëheqje të përvokueshme nga këto funksione: Muhamet Selmani,

nga Ndërmarrja Publike Banesore; Laura Zherka, nga "Sport - Marketing"; Lirijeta Rexhepi, nga "Hortikultura"; Shaip Shabani, nga "Termokos" dhe Lirie Avdiu, nga "Stacioni i Autobusëve". Njëherësh propozoi që në rend të ditës të futet edhe zëvendësimi i komisionarëve aktualë të ndërmarrjeve publike me komisionarë të tjerë, për shkak të performancës së tyre dhe jo korrektësisë që kanë treguar në raport me Kuvendin e Komunës.

Kryesuesi propozoi që në këtë rend dite të futet edhe pika - Shqyrtimi i mos prezantimit të raporteve të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, dhe marrja e një vendimi lidhur me këtë. Faktikisht, zëvendësimi i anëtarëve të komisioneve të aksionarëve nëpër këto ndërmarrje, pasi që këta aksionarë nuk iu kanë përgjigjur këtij Kuvendi.

Ylli Hoxha, shef i GP të LVV-së, ngriti shqetësim rreth propozimit të kësaj pike, duke thënë se ekziston lidhje e qartë afërsie në mesin e 10 anëtarëve të kësaj Asambleje në ushtrimin e kësaj detyre, andaj kërkoj nga kryesuesi i Kuvendi që ta parandalojë konfliktin e interesin. Mbi këtë bazë, ai kërkoj që në përputhje me nenin 38, paragrafi 4, të Ligjit për vetëqeverisje lokale, në lidhje me çështjen e lartcekur, menjëherë të merren masa lidhur me këtë çështje për secilin prej anëtarëve të Kuvendit për të cilët kemi bazë për konflikt interesi.

Lidhur me këtë, ai i bëri publik emrat e anëtarëve të Kuvendit, duke thënë se nëse ata votojnë për ndërmarrjet publike, janë në konflikt të drejtpërdrejt të interesit.

Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, nuk deshi të debatojë në hollësi lidhur me propozimin e z. Lirak Çelaj, për tërheqjen e anëtarëve të PDK-së nga komisionet e aksionarëve, duke thënë se nuk kemi asnjë arsye para vetes se pse tërhiqen nga komisionet. Ai tha se nëse duhet të shkarkohet ndonjë komision i aksionarëve, duhet të shkarkohet me argumente shumë të forta, të sinqerta dhe transparente, përndryshe ne tërhiqemi nga ai votim. Ai u përqendrua në komisionin e aksionarëve të ndërmarrjes "Stacioni i Autobusëve", ku edhe ka qenë anëtarë, duke thënë se kanë pasur bashkëpunim të mirë edhe me anëtarin e subjektit politik PDK.

Rreth pikave të propozuara të rendit të ditës diskutuan edhe: **Agim Gashi, Shefki Gashi, Sami Hamiti, Shpend Ahmeti, kryetar, Flamur Shala, Qëndron Kastrati, Dardan Sejdiu, nënkryetar, Hazir Borovci, Kreshnik Ahmeti, Sadri Ramabaja, Hatixhe Pupovci, Fadil Gashi, Shaip Hajrizi dhe Muhamet Selmani**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Duke pasur parasysh diskutimet rreth rendit të ditës, si dhe rrjedhjen e seancës, **Kryesuesi** propozoi një pauzë prej 15 minutash, në mënyrë që të bëhet një konsultim me Kryetarin, nënkryetarin dhe shefat e grupeve parlamentare, për të analizuar mundësinë e vazhdimit të seancës.

Për shkak të rrethanave të krijuara në sallë, seanca e Kuvendit u ndërpre në orën 11:30.

Vazhdimi i seancës në orën 14:00.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit, duke shtuar se për shkak të rrethanave të krijuara në sallë, u detyruam ta ndërpresim mbledhjen, por në bazë të diskutimeve që i patëm me shefat e grupeve parlamentare të subjekteve politike, bazuar në nenin 46 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, mund të konstatojmë se ekziston kuorumi, ku janë prezent njëzetegashtë (26) anëtarë, dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen.

Për propozimin e dhënë nga z. Çelaj dhe nga kryesuesi i Kuvendit, njëzëri u konstatua që këto propozime të futen për shqyrtim në rend dite.

Kryesuesi tha se pikat 3, 4, 5, dhe 6 të rendit të ditës, të cilat ishin të propozuara, ato u anashkaluan, sepse pa prezencën e Kryetarit dhe të ekzekutivit nuk mund t'i diskutojmë dhe votojmë.

U konstatua se njëzëri u miratua ky

R E N D D I T E:

- 1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë dhe të mbledhjes urgjente të Kuvendit;**
- 2. Shqyrtimi i mos prezantimit të raporteve të komisioneve komunale të aksionarëve të NPL-ve, dhe marrja e vendimit vijues;**
- 3. Propozimvendimi për caktimin e dy anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Prishtinës në Komitetin për Politikë dhe Financa;**
- 4. Propozimvendimi për këmbimin e pronave komunale me prona në pronësi të personave fizikë;**
- 5. Pyetje dhe përgjigje;**
- 6. Të ndryshme.**

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë dhe të mbledhjes urgjente të Kuvendit.

Shaip Hajrizi tha se në mbledhjen e kaluar i kam parashtruar pyetje drejtorive përkatëse, për ndriçimin e rrugëve në lagjen "Kodra e Trimave" dhe për rregullimin e ashensorëve në lagjen "Kodra e Diellit", por nuk kam marrë përgjigje, andaj kërkoj nga drejtoritë që për pyetjet që i bëjmë, mos të injorohemi, por t'i kthejnë përgjigjet ashtu siç duhet me i kthyer.

Faqe 3 nga 6

Abit Kastrati u shpreh se është hera e dytë që parashtroj pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe për Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, por nuk më kthehet përgjigje. Kam kërkuar të dijë se çka është bërë me objektin e një anëtari të LVV-së, i cili ka qenë në projekt për rrënim, që gjendet afër Parkut të qytetit. Kërkoj që në të ardhmen të na jepen përgjigjet.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan ekstrakti i mbledhjes së dhjetë dhe i mbledhjes urgjente të Kuvendit.

Pika e dytë

Shqyrtimi i mos prezantimit të raporteve të komisioneve të aksionarëve të NPL-ve, dhe marrja e vendimit vijues.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit, duke shtuar se ne kemi kërkuar që komisionet e aksionarëve t'i raportojnë këtij Kuvendi për punën që janë duke e bërë në ndërmarrjet publike lokale. Meqë neve nuk na janë përgjigjur, edhe përkundër pyetjeve që kemi bërë në mbledhjet e rregullta, dhe për këtë kemi mbajtur edhe mbledhje të jashtëzakonshme, ku nga ky Kuvend është marr vendim që komisionet e aksionarëve t'i raportojnë Kuvendit për punën të cilën janë duke e bërë.

Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, tha se për shkak të performancës jo të mirë dhe jo korrektësisë së anëtarëve të komisioneve komunale të aksionarëve që kanë pasur në raport me Kuvendin e Komunës, propozojmë që të bëhet zëvendësimi i tyre me anëtarë të tjerë të Kuvendit. Në kuadër të kësaj, ai i propozoi këta anëtarë për komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike komunale: Laura Zherka, Ndërmarrja Publike Banesore; Muhamet Selmani, ngrrohtorja e qytetit "Termokos"; Shaip Shabani, ndërmarrja publike "Stacioni i Autobusëve"; Shemsi Veseli, ndërmarrja publike "Sport -Marketing"; Lirie Avdiu, ndërmarrja publike "Trafiku Urban"; Lirjeta Rexhepi, ndërmarrja publike "Hortikultura" dhe Lirak Çelaj, ndërmarrja publike "Prishtina Parking".

Agim Gashi, në emër të GP të LDK-së, u shpreh i pajtimit me propozimin e shefit të GP PDK-së, duke thënë se edhe ne do t'i propozojmë kandidatët tanë që do të jenë anëtarë të komisioneve të aksionarëve në mandatin e ardhshëm. Ai propozoi që së pari të merret vendimi për shkarkim, bazuar në faktet të cilat u dhanë nga parafolësit.

Për këtë pikë diskutuan edhe **Sami Hamiti, Shemsi Veseli, Shefki Gashi dhe Flamur Shala**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas të gjithave diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim shkarkimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve të subjekteve politike, përveç të subjektit politik PDK, të cilët kanë dhënë dorëheqje.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për shkarkimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës dhe dorëheqja e anëtarëve të subjektit politik PDK nga këto ndërmarrje publike.

Hazir Borovci, nga radhët e subjektit politik LDK, për komisionet komunale të aksionarëve propozoi këta anëtarë: Besa Rafuna, Ndërmarrja Publike Banesore; Sokol Krasniqi, ndërmarrja komunale "Pastrimi"; Mustafë Krasniqi, ndërmarrja publike komunale "Pastrimi"; Shiqeri Spahiu, ndërmarrja publike "Trafiku Urban"; Shefki Gashi, ndërmarrja publike "Stacioni i Autobusëve"; Shaip Hajrizi, ndërmarrja publike "Hortikultura"; Ajnishahe Azemi, ngrohtorja e qytetit "Termokos"; Hasime Krasniqi, ndërmarrja publike "Sport - Marketing" dhe Abit Kastrati, ndërmarrja publike "Prishtina Parking".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

Pika e tretë

Propozimvendimi për caktimin e dy anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Komitetin për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se, sipas rregullores është e paraparë që numri i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa nga 9, duhet të jetë 11 anëtarë, dhe duhet ta kemi parasysh që të respektohet struktura gjinore, që do të thotë se duhet të jenë të gjinisë femërore.

Për anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa u propozuan Besa Rafuna (LDK) dhe Laura Zherka (PDK).

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e dy anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Shemsi Veseli njoftoi se Laura Zherka ka qenë anëtare e Komitetit për Komunitete, andaj propozoj që në vend të saj të caktohet Lirijeta Rexhepi.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete.

Pika e katërt

Propozimivendimi për këmbimin e pronave komunale me prona në pronësi të personave fizikë

Shiqeri Spahiu tha se GP i LDK-së si në rastin e parë, ashtu edhe në rastin e dytë të këmbimit të pronave, i ka trajtuar dhe i ka përpunuar, andaj vlerëson se ka bazë ligjore që këto këmbime të bëhen me qëllimi të realizimit të projekteve. Për arsyetimet të cilat po u përcjellën asamblistëve, u shpreh se ato janë shumë stereotipe, të përgjithshme, andaj propozoj që, së paku në kuadër të atij arsytimi që bëhet rregullisht (për të mos thënë që është i gabuar), të konkretizohet për secilin projekt veç e veç, të specifikohet, të dihet më saktë se çka kërkohet dhe përse bëhet ai propozim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan Vendimi për këmbimin e pronave komunale më prona në pronësi të personave fizikë.

Mbledhja mbaroi në orën 15:30.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.**